



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 07.10.2019, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhje së datës 30 shtator 2019.
2. Shqyrtimi i projektligjit për rininë.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Alban Zeneli, Andi Përmeti, Adriatik Alimadhi, Aurora Mara, Elena Xhina dhe Ediola Braha

Mungojnë:

Fatmir Xhafaj, Damian Gjiknuri, Spartak Braho, Elda Hoti, Nikolin Staka dhe Tom Doshi

Të ftuar:

Lorena Haxhiu – Zëvendësministre e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve

Erzen Tola – Drejtor në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi është i pranishëm për të vazhduar me rendin e ditës. Si pikë të parë kemi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 30 shtator 2019 për Komisionin e Ligjeve.

A ka vërejtje për procesverbalin?

Nuk ka.

Miratohet procesverbali i mbledhjes së Komisionit të Ligjeve për datën 30 shtator 2019.

Vazhdojmë me çështjen e dytë që kemi në rendin e ditës, shqyrtimin e projektligjit për rininë. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi dhe relatore e këtij projektligji është kolegja Vasilika Hysi.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Arsimit, zonja Lorena Haxhiu, zëvendësministre dhe zoti Erzen Tola, drejtor në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator.

Në fakt, prezantimi i projektligjit për rininë është bërë në Komisionin e Ligjeve, por nuk është votuar projektligji në parim. Gjithsesi, duke qenë se ky projektligj është prezantuar në parim në sesionin që sapo kaluam, ftoj zonjën Haxhiu të na bëjë një prezantim të shkurtër të projektligjit për kolegët e komisionit e më pas fjalën e ka kolegja Hysi për të vazhduar me relatimin e këtij projektligji. Dua të sjell në vëmendjen e kolegëve, meqenëse ky projektligj nga relatorja dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit, por edhe këshilltarët e komisionit është punuar javën që shkoi, është mundësia që sot ta kalojmë jo vetëm në parim, por edhe nen për nen dhe në tërësi këtë projektligj për t'ia kaluar më pas komisionit përgjegjës për të vazhduar me miratimin e projektligjit për në seancë plenare.

Zonja Haxhiu, fjala është për ju.

Lorena Haxhiu – Faleminderit, zoti kryetar!

Mirëdita të gjithëve!

Të nderuar deputetë,

I uroj punë të mbarë komisionit për ditën e sotme!

Ashtu sikurse ju e prezantuat shkurtimisht, do të risjell edhe një herë në vëmendjen tuaj projektligjin për rininë. Nisur nga rëndësia e përmirësimit të legjislacionit në sektorin e rinisë,

bazuar edhe në nevojat e identifikuar nga konsultimet me grupet e interesit u vlerësua si i domosdoshëm hartimi dhe miratimi i një projektligji për rininë, i cili është një ligj kuadër që ka si funksion bazik rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve, gjithashtu edhe sigurimin e mbështetjes së drejtpërdrejtë edhe përmes financimit nga ana e shtetit përkundrejt të rinjve dhe të rejave në Republikën e Shqipërisë.

Më konkretisht, ky projektligj synon plotësimin e kuadrit ligjor dhe institucional për të rinjtë; mbrojtjen e të drejtave të të rinjve dhe garantimin e përputhshmërisë me rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare në këtë fushë; përcaktimin e funksioneve dhe kompetencave të institucioneve qendrore dhe vendore publike, si dhe të organizatave që ushtrojnë veprimtari për/dhe në fushën e rinisë dhe krijimin e kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve për përmbushjen e potencialit të tyre në interes të shoqërisë.

Është shumë e rëndësishme të thuhet se ky projektligj ka kaluar përmes një procesi model konsultativ me të rinj dhe të reja në gjithë Republikën e Shqipërisë, i cili ka nisur që në korrik të vitit të shkuar me një konferencë kombëtare, ku të pranishëm kanë qenë të gjitha grupet e interesit, kemi kaluar në një konferencë rajonale, ku të ftuar kanë qenë homologët tanë që kanë sjellë eksperiencën e vendeve të tyre ku zbatohet aktualisht një projektligj për rininë dhe e kemi përmbyllur me një tryezë konsultative masive me mijëra të rinj dhe të reja në 12 qarqet e Republikës.

Sot, të gjithë keni përpara këtë dokument, i cili përmban 6 krerë dhe 20 nene.

Konkretisht, kreu I “Dispozita të përgjithshme”, Kreu II “Organizimi institucional”, Kreu III “Puna rinore”, Kreu IV “Financimi”, Kreu V “Infrastruktura rinore” dhe Kreu VI “Dispozita të fundit”.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Haxhiu!

Fjalën e ka zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Po ju sjell edhe një herë në memorie diskutimin që kemi bërë për projektligjin për rininë. Gjatë diskutimit në parim të projektligjit ne kemi shtruar një sërë pyetjesh për propozuesin, Ministrinë e Arsimit, njëkohësisht kërkuam edhe informacion lidhur me konsultimin publik.

Do të doja t'ju vija në dijeni se Ministria e Arsimit, drejtpërsëdrejti vetë ministrja, por edhe stafi që ka punuar për këtë projektligj, na vunë në dispozicion në adresën e Komisionit të Ligjeve procesverbalet e zbardhura të konsultimit publik me organizatat rinore në të gjithë vendin, por njëkohësisht u dhanë përgjigje edhe një sërë pyetjeve, të cilat unë si relatore i parashtrova në prezantimin tim.

Gjithashtu, kemi punuar me një grup pune dhe materiali që ju keni përpara është një material i dakordësuar me Ministrinë e Arsimit.

E para, dua të theksoj, sepse mund t'ju duken sikur janë shumë ndryshime, por, në fakt, nuk ka ndryshime, janë saktësime, riformulime dhe ndarje nenesh për ta bërë ligjin më të qartë. Në këtë kuadër, meqenëse komisioni ynë është për dhënie mendimi, amendamentet për Komisionin e Edukimit dhe të Informimit publik i kemi të gati me qëllim që të shprehim qartë qëndrimin dhe vlerësimet tona.

Zoti kryetar, në këtë kuadër dua të falënderoj zonjën Shahini, ministre e Arsimit, por edhe zëvendësministren që është e pranishme në komision, si dhe drejtorin Juridik, zotin Erzeni, pasi kemi punuar së bashku, por edhe me këshilltaren e Komisionit të Ligjeve dhe besoj se kemi sjellë një projekt, i cili i ka të gjitha diskutimet që janë bërë në konsultimin publik, shqetësimet që kanë pasur organizatat e shoqërisë që punojnë me të rinjtë ose për të rinjtë.

Do t'ju sugjeroja që projektligjin ta miratojmë në parim dhe më pas të kalojmë në diskutimin nen për nen.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

A ka pyetje nga kolegët?

Nuk ka.

A ka diskutime?

Nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim.

Hedhim në votim në parim projektligjin. Kush është dakord? Kundër? 3 kundër. Abstenim?
Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji për rininë.

Kalojmë në shqyrtimin dhe miratimin nen për nen të projektligjit. Siç e tha edhe relatorja Hysi, kolegët kanë mbi tavolinë variantin e integruar të projektligjit, ku janë bërë riformulimet dhe ndryshimet e propozuara nga grupi i punës dhe relatori.

Zonja Hysi, do të dëshiroja të më ndiqnit nen për nen. Nuk besoj, edhe për efekt kohe, nëse keni rënë dakord për riformulimet dhe sugjerimet konkrete në nene të caktuara të mos i lexoni riformulimet, por, gjithsesi aty ku e çmoni se duhet të jepet një shpjegim lidhur me ndërhyrjen mund ta bëni.

Neni 1, i përket Kreut I që fillon me Dispozita të përgjithshme” dhe është “Qëllimi i projektligjit”.

Vasilika Hysi – Nenin 1 e kemi ndarë në dy nene, duke shtuar një nen të ri, i cili do t'i paraprijë nenit 1 të propozimit të qeverisë i titulluar “Objekti”. Neni 2, do të jetë “Qëllimi”.

Pra, është e njëjta përmbajtje me projektin e sjellë nga qeveria, por kemi ndarë objektin dhe qëllimin në dy nene të veçanta në përputhje me rregullat e teknikës legislative.

Ulsi Manja – Neni i ri që është shtuar ka të bëjë me objektin?

Vasilika Hysi – Po.

Ulsi Manja - Kush është dakord të shtohet një nen i ri lidhur me “Objektin”? Kundër? 3 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet shtimi i një neni të ri që është “Objekti” i projektligjit.

Kalojmë te neni 2.

Po, zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Te neni 1, shkronja “a”, ndoshta kjo i shërben edhe mënyrës së artikulimit: “Mbrotjtjes së të drejtave të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse”. Fjala “në mënyrë...

(Diskutime pa mikrofon)

Vasilika Hysi – E kemi riformuluar.

Adriatik Alimadhi – Ku e keni?

(Diskutime pa mikrofon)

... të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse...

(Diskutime pa mikrofon)

Unë nuk e kam këtë.

Ulsi Manja – Tabela.

Adriatik Alimadhi – Atëherë nuk ka ndonjë problem, por vetëm fjala “në mënyrë” të hiqet, ndërsa fjalën “gjithëpërfshirëse” mund ta lini.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Kalojmë te neni 2 “Qëllimi”. Neni 1 bëhet neni 2.

Vasilika Hysi – Neni 1 bëhet neni 2, i cili ka si objekt “Qëllimin”, por është i ndarë, sepse edhe neni 1 që sapo miratuam zoti kryetar, ka qenë pjesë e nenit 1 të projektligjit por e kemi ndarë në dy pjesë.

Ulsi Manja – Po, është shtuar një nen i ri.

Kush është dakord me nenin 2, i cili bëhet “Qëllimi”?

Zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Edhe këto që na vijnë na vijnë gjysma.

Te shkronja “f” në të cilën thuhet: “Të rinjtë, personat që kanë mbushur moshën 15...

(Diskutime pa mikrofon)

Po neni 2 është?

Ulsi Manja – Neni 1 është ndarë në 2 nene, është shtuar një nen i ri që kishte të bënte me objektin, ndërsa tani po flasim për qëllimin, nuk kemi shkuar ende te përkufizimet.

Adriatik Alimadhi – Ju thatë neni 2 prandaj.

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Fino, e ka fjalën.

Bashkim Fino – Jam plotësisht dakord me vërejtjet që bën opozita, nuk diskutohet edhe për përmirësimet, por në fund të ditës duhet të ketë efektivitet. Cila është? Nëse për ndryshimet që i bëhen nenit përkatës ne e marrim në konsideratë, por opozita nuk e voton, nuk ia vlen më që të bësh propozim. Unë i bëj propozimet dhe patjetër që duhen, por në momentin që ne e marrim në konsideratë dhe e ndryshojmë, siç po thoni ju tani, çfarë kuptimi ka të votojmë prapë kundër, nuk ka logjikë dhe është harxhim kohe.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Edhe pse nuk e votuan në parim...

(Diskutime pa mikrofon)

Kush është dakord me nenin 2 “Qëllimi”. Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 2.

Kalojmë te neni 2 që bëhet neni 3 “Përkufizime”.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, në këtë nen kemi bërë riformulim të shkronjës “c”, njëkohësisht në shkronjën “d” kemi hequr një shprehje që është “organizatat rinore dhe shoqëritë”. Në shkronjën “dh” i kemi rekomanduar komisionit përgjegjës që ta rishikojë ose ta heqë nga përmbajtja e projektligjit fjalën “punonjës rinorë” pasi nuk del e qartë, por këtë gjë e kemi ngritur edhe gjatë diskutimit në parim të projektligjit. Për shkronjën “ë”, e cila përkufizon “Subsidiaritetin”, kemi thënë që ky përkufizim jepet te ligji përkatës për vetëqeverisjen vendore dhe nuk është e nevojshme të riformulohet, prandaj duhet të hiqet. Ndërsa shkronjat “g” dhe “gj” janë në variantin ka sjellë qeveria, por kemi shtuar vetëm një fjalë: “Organizatat rinore të jenë të krijuar dhe regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi “Për organizatat jofitimprurëse””. Kjo është shtesa.

Pra, është sikurse e ka sjellë qeveria, por kemi saktësuar që organizatat duhet të jenë krijuar dhe regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në fund i kemi sugjeruar komisionit përgjegjës që të gjitha përkufizimet t’i rendisin sipas rendit alfabetik.

Ulsi Manja – Jeni dakord me sugjerimet e bëra nga ana e relatores?

Po, zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Qëndron në fuqi ajo që tha zoti Fino?

Ulsi Manja – Parimisht ajo që tha zoti Fino qëndron, megjithatë ne nuk ia mohojmë të drejtën e fjalës opozitës.

Adriatik Alimadhi – As të drejtën e fjalës nuk do të na jepni? Atëherë unë po largohem.

Ulsi Manja – Mund ta merrni fjalën...

(Diskutime pa mikrofon)

Adriatik Alimadhi – Sa i takon shkronjës “f”, në të cilën thuhet: “Të rinjtë, personat që kanë mbushur moshën 15 vjeç deri në 25 vjeç...” A nuk është gabim mosha 15 vjeç, sepse nuk e kanë mbushur moshën madhore me zotësi.

Ulsi Manja – Sa ta bëjmë?

Adriatik Alimadhi – 18.

(Diskutime pa mikrofon)

Po ju kështu i doni të vegjël që t’i gënjeni politikisht.

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 2 që bëhet neni 3 “Përkufizime” me sugjerimet e relatores? Kundër? 3 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 3 që bëhet neni 4 “Parimet për mbështetjen e veprimtarisë së të rinjve”.

Vasilika Hysi – Janë vetëm të riformuluara, duke theksuar parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit dhe të mundësive të barabarta të të rinjve.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 3 që bëhet neni 4? Kundër? 3 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 4 “Rrjeti rinor”, i cili bëhet neni 5.

Zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Ka një ndryshim, së pari titulli i kreut, të cilin e kemi quajtur “Organizimi institucional”. I rekomandojmë komisionit përgjegjës riformulimin ose heqjen e këtij neni, pasi në mënyrën si është formuluar nuk është i qartë.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 4 që bëhet neni 5 me sugjerimet e relatores? Kundër? 3 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 5.

Kalojmë te neni 5 që bëhet neni 6 “Ministria përgjegjëse për rininë”. Edhe këtu propozohen ndryshime nga relatorja.

Vasilika Hysi – Këto janë dakordësuar me ministrinë përgjegjëse për rininë me të vetmin dallim që shkronja “c”, të cilën e kemi riformuluar dhe themi: “Mbledh, analizon të dhënat, si dhe publikon raportet e vlerësimit mbi situatën e të rinjve në bashkëpunim me institucionet e tjera dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”, sugjerohet edhe nga konsultimi që bëmë para kësaj mbledhjeje të hiqet dhe t’i kalojë institucionit përgjegjës për rininë. Pjesa tjetër janë riformulime të neneve. Njëkohësisht kemi shtuar, zoti kryetar dhe të nderuar kolegë, 3 shkronja, shkronjat “f”, “g” dhe “gj” ku kemi vënë në dukje përgjegjësinë që ka ministria përgjegjëse për rininë që të hartojë dhe të propozojë bazën ligjore në fushën e rinisë, të sigurojë ofrimin e shërbimeve për të rinjtë dhe të sigurojë zhvillimin e konsultimeve me të rinjtë, konsultimin publik dhe gjithëpërfshirjen e të rinjve.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Kush është dakord me nenin 5 që bëhet neni 6 me sugjerimet e dakordësuara? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 6 që bëhet neni 7 “Institucionet e tjera qendrore”. Këtu nuk ka propozime.

Kush është dakord? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 7 që bëhet neni 8 “Njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Këtu kemi reflektuar një kërkesë të ligjit për vetëqeverisjen vendore, duke shtuar pikën 2/1, ku u japim të drejtë njërive të vetëqeverisjes vendore të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe të lidhin marrëveshje. Kjo është e parashikuar në ligjin për vetëqeverisjen, edhe në rastin e veprimtarive të rinisë ato mund të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Fjalën e ka kërkuar zoti Fino për pyetje.

Bashkim Fino – Unë e kam kërkuar fjalën për të sqaruar diçka. Ne kemi një ligj të organeve të pushtetit vendor, i cili ka disa funksione, ndërsa sot me këtë ligj u japim një funksion tjetër, funksionin për çështjet e rinisë.

Zonja Hysi, u shpreh që, edhe nëse vihet apo nuk vihet kjo, pak rëndësi ka, sepse këtë gjë e ka ligji për organizimin e pushtetit lokal kur bashkitë mund të koepërojnë me një-tjetrën për një aktivitet e të tjera. Ajo që mua më dhemb dhe të cilën dua ta trajtoj janë gërmat “dh” “e” dhe “ë” në të cilat thuhet, pasi thuhet pika 1: “Njësitë e qeverisjes vendore në përputhje me funksionet e tyre hartojnë dhe zbatojnë politika vendore në fushën e rinisë, si dhe janë përgjegjëse për financimin e krijimit dhe zhvillimin e infrastrukturës rinore në hapësirat rinore të sigurta; krijimin e strukturës administrative për çështjen e rinisë dhe parashikimin e buxheteve të tyre të fondeve për realizimin progresiv të të drejtave të të rinjve për zhvillimin e projekteve, të programeve” e të tjera me radhë. Çfarë dua t’ju them për këto tri pika. Vasilika, të lutem, më ndiq, sepse janë tri çështje që ti duhet t’i trajtosh dhe që u japin një funksion të ri organeve të pushtetit vendor.

Cili është efekti financiar? A ka efekt financiar? Natyrisht, që ka. Në momentin që ka efekt financiar, atëherë patjetër duhet të bësh konsultim me shoqatat e bashkive dhe t’u thuash: “I dashur përfaqësues i bashkisë ne do të japim një funksion të ri dhe për këtë funksion do të të japim iks

fonde dhe iks numër punonjësish, nëse do të ketë, në të kundërtën nëse do të ngelet kështu dhe unë nuk kam ndonjë vërejtje për mënyrën se si është trajtuar, që i jepet një detyrë tjetër pushtetit vendor, do të ngelet në letër dhe asnjë kryetar bashkie nuk do ta zbatojë. Do të thuash që nuk ka mundësi të mos e zbatojë ligjin? Ai fare thjesht mund të thotë që nuk më ke dhënë numër punonjësish dhe as fonde, kështu që unë nuk kam ku t'i gjej, sepse atë fond që marr nga buxheti, qoftë nga fondet e pakushtëzuara apo nga të ardhurat e mia. Unë e trajtoj këtë çështje në këshillin e bashkisë, miratoj strukturën, ashtu siç e kam me ligj, miratoj edhe ndarjen e fondeve dhe në këtë rast fondi mund të ngelet ose jo. Edhe pa qenë ky ligj, përsëri kryetari i bashkisë ka pasur mundësi të bëjë aktivitete të ndryshme si për kulturën, rininë e të tjera me radhë, por në momentin që ne e vëmë në ligj, kjo patjetër duhet të ketë një efekt financiar.

Cili është efekti financiar? Unë dua të di se cili është bashkëpunimi ndërmjet ministrisë së linjës që mbulon rininë, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Brendshme, që mbulon organeve të pushtetit vendor, shoqatat e të tjera me radhë nëse i kanë dhënë një faturë financiare apo jo? Nëse nuk kanë dhënë faturë financiare, më falni që po jua them, kjo do të ngelet thjesht e shkruar në letër, por asnjë kryetar bashkie nuk do ta zbatojë.

Më vonë do të flas edhe për 2-3 nene të tjera që kanë lidhje me këtë çështje. Ky është thelbi i diskutimit për këtë nen, çfarë do të bëhet me të? Sepse kështu siç është shkruar nuk ka asnjë problem, po ashtu edhe sugjerimin që bëri Vasilika mos ta trajtojmë, se është në ligj. Mjafton të jetë e ndarë dhe jemi në rregull.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Zonja Haxhiu, të lutem, një shpjegim nga ana juaj në lidhje me çështjet që sapo ngriti zoti Fino.

Lorena Haxhiu – Faleminderit, zoti Fino!

Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, para se të kaloj në përgjigjen konkrete, dua t'ju them që ky ligj është konsultuar që në fazën e hershme të trajtimit të tij edhe me organet e pushtetit vendor, pra me njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe me Agjencinë për mbështetjen e tyre, lidhur me efektet financiare, ku konkretisht parashikohet. Në germën “dh” të këtij neni “Financimi për krijimin dhe zhvillimin e infrastrukturës rinore dhe të hapësirave rinore të sigurta” parashikohet të jetë brenda fondit grant dedikuar për rininë, konkretisht te financimi i politikave, programeve dhe projekteve rinore në

nenin 16 të këtij ligji, ku shprehimisht thuhet se fondi grant nga buxheti i shtetit do të përdoret për, së pari, financimin e ndërtimit ose rikonstruksionit ose subjekteve publike dhe të infrastrukturës rinore. Kjo do të thotë se këto objekte sot janë në pronësi të bashkive dhe ministria nuk mundet dot të financojë drejtpërdrejtë. Sipas legjislacionit që kemi në fuqi, edhe qendrat rinore që hyjnë te hapësirat e sigurta ose tek infrastruktura do të financohen po njëjllë. Kjo është e kostëzuar .

Ndërsa sa u takon dy pikave të tjera, më lejon të sqaroj se deri vitin e kaluar plani ynë buxhetor e lejonte që rinia dhe sporti të ishin në një zë, tani rinia është në një zë të veçantë, çka do të thotë se propozimi për implementimin e dy pikave të tjera që kanë lidhje me financimin e pushtetit vendor sigurisht do të parashikohen nga Ministria e Financave.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Zoti Fino.

Bashkim Fino- Së pari, falënderoj zëvendësministren për argumentimin shumë shterues, që na kënaqi të gjithëve këtu.

Por unë jam pak skeptik. Cili është problemi im? Unë mund të mos jem relatori i buxhetit këtë rradhë, por problemi qëndron në faktin nëse do të na vijë e detajuar në buxhet kjo gjë? Në momentin që do të na vijë e detajuar unë nuk do të kem asnjë vërejtje, sepse e di që është për rininë dhe nuk do të përdoret për asnjë gjë tjetër. Por unë do të doja të dija edhe numrin e punonjëseve. Prandaj them, zoti kryetar se ka një nënkomision të pushtetit vendor, të cilin duhet ta respektojmë, duhet ta mbledhim. Zëvendësministrja sapo tha që është rakorduar me agjencinë. Agjencia është institucion shtetëror, shumë mirë që ka rakorduar me të, por duhet të flitet me kryetarët e bashkive, me shoqatat e tyre, sepse ata janë njerëzit e zgjedhur drejtpërdrejt, duhet të vijmë këtu të bëjmë një takim dhe të thonë mendimet e tyre si duhet të realizohet, jo me agjencitë, sepse agjencia në Ministrinë e Financave duhet drejtuar.

Mua nuk më krijon asnjë lloj problemi, është shumë i saktë i shkruar këtu dhe jam gati ta votoj, por problemi është të zbatohet dhe si do të realizohet në fund të buxhetit për këtë vit.

Nëse ti më jep garancinë që do të vijë i detajuar me efektet financiare, unë jam dakord.

Vasilika Hysi – Problematika që ngre zoti Fino është shumë e drejtë. Edhe në diskutimin në parim unë kam shtruar tri pyetje lidhur me këtë çështje duke pasur parasysh se në bazë të nenit 22, paragrafi 2, të ligjit nr. 139 të vitit 2015 për vetëqeverisjen vendore, funksionet njësie vendore rregullohen me këtë ligj, por funksionet e dhe kompetencat e tjera mund të njihen edhe

me ligje të tjera. Në këtë kuadër është e drejtë dhe pajtohem me pjesën e parë të diskutimit të kolegut Fino që në një ligj tjetër ne mund t'i caktojmë kompetencat.

Për tri pyetjet që unë kam parashtruar në takimin që kemi bërë më është dhënë përgjigje pozitive nga zëvendësministrja.

Kështu, pyetjes: a i është nënshtruar kjo nismë procesit të konsultimeve me shoqatat e përfaqësuesve të qeverisjes vendore, më është thënë: po.

Së dyti, lidhur me çështjen a kanë njësitë e vetëqeverisjes vendore kapacitetet e mjaftueshme njerëzore, unë kam sugjeruar që në raportin që do t'i bëhet komisionit përgjegjës, por edhe në diskutimin në seancë do të lihet detyrë që organet e qeverisjes vendore të kenë një buxhet të dedikuar për këtë çështje, lidhur edhe me burimet njerëzore që kanë.

Së treti, në lidhje me pyetjen e tretë: nëse janë parashikuar burimet e nevojshme financiare për realizimin e këtij funksioni ,nga relacioni rezulton se ka një buxhet. Në këtë kuadër i konsideroj si një kujdes dhe vlerësoj vëmendjen e komisionit dhe kolegut Fino dhe do të jemi shumë të kujdesshëm në raportin që do të shoqërojë amendamentet për komisionin përgjegjës, por të theksohet kjo edhe në raportin që do t'i shkojë seancës plenare. Kur të vijë buxheti, besoj ne do të jemi të gjithë të vëmendshëm, sepse u kemi shtuar kompetenca edhe me ligjin për diasporën organeve të qeverisjes vendore jo më parë se një muaj.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Unë do të shtoja se, duke qenë se e kemi nënkomisionin për qeverisjen vendore, në momentin që do të na vijë buxheti, zoti Fino, që ky parashikim ligjor të mos mbetet thjesht në letër, pra në ligj, por të shoqërohet edhe me garancitë e duhura buxhetore për njësitë e vetëqeverisjes vendore, buxheti i bashkive të kalojë te nënkomisioni për pushtetin vendor, ku ne kemi mundësi të çekojmë dhe të kontrollojmë se sa ky ligj do të mbështetet edhe me buxhetin përkatës për rininë në nivelin vendor.

Ta hedhim në votim nenin 7, që bëhet neni 8, duke parashtruar në raportin që do t'i përcjellim komisionit përkatës edhe këtë shqetësim që u ngrit në komisionin tonë, sepse, sado të mira t'i kemi ligjet, nëse nuk zbatohen siç duhet, mbesin thjeshtë deklarative dhe në letër. Kush është dakord me nenin 7 që bëhet neni 8? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Asnjë.

Miratohet.

Kalojmë te neni 8 që bëhet neni 9 “Institucioni përgjegjës për rininë”.

Zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Ky është një institucion i ri që krijohet në vartësi të Ministrisë së Arsimit. Këtu kemi bërë një riformulim të shkronjës “b” që pas fjalës “monitorim” themi “mbikëqyr”, dhe pas shkronjës “dh” kemi sugjeruar të shtojmë shkronjën “dh/1” dhe “dh/2”. Kompetenca që ne e hoqëm te neni 5 i projektligjit të sjellë nga qeveria, ku thuhet: “mbledh, analizon të dhënat, publikon raportet e vlerësimit për situatën e të rinjve në bashkëpunim me institucionet e tjera dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore” do të shtohet pikërisht te ky nen.

Ulsi Manja – Po, zoti Fino.

Bashkim Fino- Do të ndalem te neni 8 “Institucioni përgjegjës për rininë”. A ka titull ky institucion? Si do të quhet? A do të quhet Instituti i Rinisë? Ju thoni institucioni përgjegjës për rininë. Cili do të jetë emri i këtij institucioni, i cili do të jetë jashtë ministrisë, por në varësi të saj? Pra, duhet at formuloni në ligj, sepse kështu ia lini në dorë çdo ministri që vjen ta ndryshojë si të dojë emërtimin e institucionit.

Së dyti, te pika 2, shkronja “ç”, thuhet: “Ky institucion do të mbështesë rritjen e kapaciteteve të njësive të strukturave në nivel qendror dhe vendor”. Çfarë do të thotë kjo? Ky institucion në nivel qendror varet nga ministri. A do të krijojë struktura të tjera në nivel qendror ky institut? Si do të mbështesë ky institut ngritjen e kapaciteteve për ato vendore? A do të komunikojë me ta?

Pra, kur krijojmë një institucion të ri, duhet t’i vëmë kompetencat tamam, pastaj jam dakord me pikën 3. Pra, më mirë ta lëmë në pikën 3 që mënyrën e organizimit e bën Këshilli i Ministrave, pra do të ketë një vendim të detajuar për të, si edhe të mos vëmë shumë pika.

Ulsi Manja - Përfaqësuesit e ministrisë, a kanë ndonjë mendim për nenin 8?

Lorena Haxhiu - Ky lloj organizimi në këtë formë është bërë si pasojë e mendimit të dhënë nga Ministria e Drejtësisë dhe DAP-i, për të mos përcaktuar institucione me emërtim konkret. Është sugjerim që është dhënë për të gjitha ligjet, emërtimi i institucionit duhet të përcaktohet me vendim qeverie.

Lidhur me kompetencat kryesore të dhëna në projektligj përsëri është kërkuar dhe sugjeruar nga Ministria e Drejtësisë që të përcaktohen vetëm funksionet kryesore në ligj dhe pastaj të tjerat do të detajohen me vendimin e qeverisë

Bashkim Fino - Mbase kjo është një metodë e re e Ministrisë së Drejtësisë e tanishme, nuk jam dakord me drejtorin juridik që thotë se kështu vijnë të gjitha ligjet. Ne kemi eksperiencë

të gjatë këtu dhe kemi miratuar shumë ligje dhe institucionet i kemi miratuar me emërtesë. Ju jeni korrekt me përgjigjen që dhatë, por realisht nuk është kështu për ligjet e tjera.

Së dyti, nëse ne kemi këtë strukturë, çfarëdo strukture tjetër qendrore të krijohet ministria përkatëse duhet ta dijë. Nëse mund të na i thotë mirë, nëse nuk mundet të na i thotë, nuk kemi pse të vëmë shkronjën “ç”. Atëherë të lëmë pikën 3, ku të përcaktohet që mënyrën e formimit, krijimit dhe funksionet i bën qeveria dhe jemi në rregull. Po në momentin që ti thua ngrihet në nivel qendror dhe vendor, atëherë duhet të ma thuash se je ministria përgjegjëse.

Ulsi Manja - Institucioni përgjegjës për rininë themelohet si person juridik, publik, buxhetor, dhe thuhet se mënyra e organizmit dhe funksionimit të institucionit përgjegjës për rininë miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Kjo do të jetë agjenci? Pra, ju sot a keni drejtori për rininë në Ministrinë e Arsimit? Ju sot a keni struktura për rininë në ministri? Cili do të jetë statusi? A do të krijohet një agjenci tjetër e re dhe ju do të vazhdoni të mbani përsëri struktura për rininë në ministri, apo do t’i merrni këtu dhe do t’ia kaloni agjencisë? Si do të jetë funksionimi i kësaj agjencie, se emrin dakord, ia keni lënë t’ia vini me vendim të Këshillit të Ministrave?

Lorena Haxhiu- Në lidhje me këtë sqarojmë se aktualisht ka një institucion në varësi të ministrisë së Arsimit dhe Rinisë, i cili quhet Shërbimi Kombëtar Rinor dhe ky është institucion, i cili do të riorganizohet në institucionin e ri përgjegjës për rininë. Institucioni do të jetë vetëm në nivel qendror dhe nuk do të ketë degë territoriale ose në nivel vendor, nuk do të ketë shtrirje.

Lidhur me shkronjën “dh”, që parashikohet në projektligj për mbështetjen që përmendi zoti Fino, sqarojmë se institucioni do të mbështesë ngritjen e kapaciteteve nëpërmjet financimit të programeve të trajnimit në njësitë vendore të administratës së njësive vendore dhe jo duke i shtrirë si strukturë vendore.

Ulsi Manja– Pra, neni 8 bëhet neni 9. Kush është dakord me nenin 8 dhe sugjerimet që bëri relatorja? Në raportin që do t’i përcillet komisionit përgjegjës do të shtojmë disa gjëra. Pavarësisht se këtu thuhet që janë bërë konsultimet me bashkitë dhe shoqatat e bashkive, komisionit përgjegjës do t’i sugjerohet që, nëse nuk është bërë siç duhet kjo fazë e konsultimit publik, të bëhet, aq më tepër që tani kemi një realitet tjetër në pushtetin vendor, mund të mos kenë qenë këta kryetarë bashkish kur është konsultuar ligji. Komisioni përgjegjës mund të organizojë seanca dëgjimore për problematikën që ne ngritëm.

Kush është dakord me nenin 8 që bëhet neni 9? Kundër? 1 kundër. Abstenime? Asnjë abstenim.

Kalojmë te neni 9 që bëhet neni 10 “Këshilli Kombëtar i Rinisë”.

Vasilika Hysi - Sikurse e kemi diskutuar, ky nuk mund të jetë një ligj kuadër i thatë dhe çdo gjë të rregullohet me VKM. Për rrjedhojë këtu kemi dy çështje për të cilat kemi debatuar. Meqenëse ky është ligj që rregullon rininë, duhet të detajojë Këshillin Kombëtar, kompetencat, përbërjen, mënyrën e zgjedhjes.

Një nga çështjet që kemi diskutuar, por nuk ka gjetur sa dhe si duhet adresim është si janë rregulluar kompetencat.

Sa i përket pikës 2 për përbërjen e Këshillit Kombëtar dhe ndarjes se çfarë do të përfaqësojnë shoqërinë civile, akademike, njohës, këtu ka vetëm një formulim që është dakordësuar me Ministrinë e Arsimit, pikërisht që këta 14 anëtarë do të gëzojnë mandat 4 – vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë, por nuk është gjetur dakordësia lidhur me kriteret dhe procedurat e zgjedhjes së këtyre anëtarëve dhe çfarë do të përfaqësojnë këta 14 anëtarë. Është këmbëngulur që kjo të rregullohet me VKM.

Ulsi Manja- Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka – Këshilli Kombëtar i Rinisë është një organ këshillimor. Kam përshtypjen që sekretariat do të ketë institucionin e ri që do të krijohet. Jam dakord që në ligj duhet të jemi të qartë sa u takon caqeve të parimeve, kriterëve kryesore, të cilat do të jenë shinat ku do të vendoset me VKM, si do të përzgjidhen anëtarët, por duke iu referuar edhe parimeve të hartimit të legjislacionit e teknikës legjislative dhe parimeve të sigurisë juridike, si edhe faktit që ne tashmë kemi një legjislacion të plotë që e kemi bërë edhe me Bashkimin Europian, edhe me konsulencat e huaja për Këshillin e Barazisë Gjinore, për Këshillin Kombëtar të Shoqërisë Civile, për Këshillin e Punës, për të cilët në ligj nuk jepen detaje si zgjidhen, do ia lëmë Këshillit të Ministrave, por me minimalisht themi se në përbërjen e këshillit sa persona janë që përfaqësojnë qeverinë ose pushtetin publik dhe sa persona janë nga grupet e interesit, sepse ky është projektligj që bëhet për grupet e interesit jo për shtetin, që garanton të drejtat publike të shtetasve, prandaj unë sugjeroj që të themi sa do të jetë përbërja dhe si ndahet kjo përbërje në raport me përfaqësimin nga pushteti dhe target grupet.

Gjithashtu, a do të vini kriteret e atyre që përfaqësojnë organizatat ose interesat rinore në ligj apo do t’ia lini VKM-ve? Këto duhen shkruar, sepse nesër do të jetë shumë e vështirë që me një vendim qeverie të përcaktohen kriteret, sepse është ndryshe akordi gjithëpërfshirës gjatë dëgjësive dhe në parlament ku ka përfaqësim politik të përgjithshëm sesa në qeveri. Pra, nesër

kam frikë se do të mbetemi në një ngërç ku qeveria do të bëjë një VKM për të zbatuar strategjitë e veta me të drejtë, por nga ana tjetër do të kemi përplasje me interesat e grupeve të interesit. Të paktën të përcaktohet sa përfaqëson një grup sa përfaqëson grupi tjetër. Nëse doni të vini kritere siç janë vënë në ligjin për këshillin kombëtar të shoqërisë civile, nuk është fare e udhës që një organizatë e sapo krijuar të përfaqësohet ndërkohë që ka pasur organizata me vite tek të cilat janë bërë zgjedhje me votë, online, të organizuara nga Agjencia për Mbështetjen e Shqipërisë Civile. Kjo është në kuadër të transparencës. Unë mendoj që, pasi të marrim edhe përgjigjen tuaj, të bëjmë një sugjerim për komisionin përgjegjës. Pra, të riformulojmë pikën 2 të nenit 9 që do të bëhet nenin 10.

Ulsi Manja -Zoti Fino.

Bashkim Fino- Unë kam një këndvështrim tjetër, jam dakord me parafolësit, por unë nisem nga koncepti që Këshilli Kombëtar i Rinisë është një organ këshillimor.

Pra, unë e thërras, më këshillon, e dëgjoj nuk e dëgjoj, vazhdoj. Kjo është në kuptimin më pragmatik të fjalës. Në momentin që është i tillë, nuk kemi pse e rëndojmë ligjin ne. Unë jam i mendimit që nuk kemi pse ta rëndojmë ligjin, sepse është këshillimor, themi krijohet, përbëhet nga kaq dhe aktet e tjera, madje unë jam që aktet t'i nxjerrë ministri, jo Këshilli i Ministrave.

Në momentin që ky këshill ka një vendimmarrje tjetër, unë mendoj që Këshilli Kombëtar të përbëhet nga 14 anëtarë. Këta e kanë studiuar, e kanë parë që mund të ketë institucione dhe organizata rinore, të cilat duhet që t'i kenë në tavolinën e madhe për t'u këshilluar dhe fare mirë mund ta lëmë 14-17 veta.

Ndërsa në lidhje me pikën e tretë, përcaktimi i anëtarëve dhe mënyra e funksionimit, unë mendoj se nuk bëhen me vendim qeverie. Jo. Ky është një këshill kombëtar rinor këshillimor që e drejton ministri. Unë jam i mendimit që numri i anëtarëve, mënyra e funksionimit dhe organizmit të dalë me urdhër të ministrit.

Jam kundër sugjerimit të zonjës Hysi që është në pikën 2, këto nuk janë institucione kushtetuese që të kenë të drejtën të jenë 4 vjet me të drejtën e rizgjedhjes. Jo, këta janë këshillues. Këtyre nuk mund t'u thuash që të rrinë 4 vjet dhe pas 4 vjetëve ke të drejtë të votohesh edhe një herë. Jo, sepse janë këshillues. Pra unë jam siç e ka sjellë qeveria me një ndryshim, jo me VKM, por me urdhër të ministrit përkatëse për rininë.

Kam një sugjerim për nenin që sapo kaluam, nga pikëpamja financiare, jo juridike, te shkronja “dh” thuhet: “siguron financime nëpërmjet aplikimit të projekteve kombëtare e

ndërkombëtare, të cilat trashëgohen në vitet pasardhëse buxhetore”. Fjala “të cilat trashëgohen” është në kundërshtim të plotë me buxhetin e shtetit. Asnjë fond nuk trashëgohet, ato ruhen dhe i jepen komisionit përgjegjës. Duhet hequr fjala “trashëgohet”, sepse është një fond që bie në kundërshtim me buxhetin e shtetit. Edhe unë, si parlament, mund të kem fonde që nuk i kam harxhuar, ose edhe ti, si ministri në vitin 2019, por nuk të trashëgohen për vitin pasardhës, sepse del një buxhet i ri me shifra të reja.

Ndaj, këshilltarët duhet ta marrin në konsideratë që fjalën “trashëgohet”, që e kanë bërë me rreth të kuq, ta heqin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, se nuk mund ta thuash në ligjin e rinisë “trashëgohet”, se buxheti i shtetit është më i fuqishëm nga ky ligj.

Ndërsa te neni 9 duhet të bëjmë vetëm këtë propozim dhe të mos e rëndojmë kaq shumë. Duhet të themi se Këshilli Kombëtar është këshillimor dhe përbëhet nga 14 deri në 17 anëtarë, pra të lemë një hapësirë, se mund të ketë edhe institucione apo organizata të tjera, Klodi e tha shumë bukur, se mund ta bëjmë edhe me 12, pra të lëmë një tavan dhe dysHEME dhe përcaktimi i anëtarëve dhe mënyra e funksionimit të bëhet me urdhër të ministrit. Këtu duhet të mbyllet dhe nuk kemi pse të merremi me këtë, pasi është një organ këshillimor dhe jo vendimmarrës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky është mendimi im. Ju e doni me VKM, bëjeni ashtu.

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Fino!

Fjala për zonjën Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

I vlerësoj shumë diskutimet e koleges Bushka dhe të zotit Fino, por kam një pyetje për zotin Fino: në rast se institucioni përgjegjës për rininë aplikon për një projekt IPA që është 2-3 vjet, pa dyshim që fondet do të trashëgohen në vitet pasardhëse, flasim për projekte ndërkombëtare, ose projekti merret në muajt tetor-nëntor, kanë faza të ndryshme. E kuptoj që në aspektin e ligjit për buxhetin e shtetit ju gjithmonë e keni theksuar dhe na e keni mësuar që buxheti nuk trashëgohet. Po në rastin e projekteve çfarë termi duhet përdorur? Pyetja e parë.

(Diskutim pa mikrofon)

Ulsi Manja - Ju lutem, për nenin 8, që u bë neni 9, te germa “dh”, të gjejmë fjalën e duhur që të qartësojmë situatën për projektet ndërkombëtare dhe kombëtare që financohen.

Lidhur me nenin 9, që u bë neni 10 “Këshilli Kombëtar i Rinisë”...

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, këtë nen e kemi diskutuar gjatë në parim dhe parashtruar disa pyetje. Nga njëra anë, po themi se po shkojmë drejt ligjeve që janë shumë kuadër, që shumë gjëra detajohen me akte nënligjore, çka do të thotë, me të drejtë e ngriti zonja Bushka, parimi i sigurisë juridike, paqartësia nga teknika legjislativë mund të vihen në diskutim, nga ana tjetër, unë nuk kam kundërshtim për numrin 14 deri në 17, sepse në fund të fundit, organ këshillimor është, por është e rëndësishme që në këtë proces të mos jenë gjithmonë të njëjtët persona. Pra, çdo ministër zgjedh këshillin e vetë konsultativ. E para.

E dyta, pajtohem këtu me zonjën Bushka, jo sepse e kam kërkuar dhe gjeta një mbështetje me argumente shumë të forta, ka disa kritere, në qoftë se ne do të vëmë këshilltarë të gjithë personat specialistë të ministrive, që lidhen në një mënyrë ose një tjetër, atëherë mund të zbehim zërin e rrjeteve rinore. Unë mendoj se më shumë duhet të jetë zëri i të rinjve, sepse qëllimi i ligjit është rritja dhe pjesëmarrja e të rinjve në këtë proces, duhet të jenë 2 – 3 përfaqësues nga institucionet dhe pjesa më e madhe 70-80 % duhet të jenë organizata rinore. Ndaj do të sugjeroja që këtë rekomandim t’ia bëjmë komisionit përgjegjës.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Fjala për zotin Hyseni.

Alket Hyseni – Duke shkruar të gjitha shqetësimet e kolegëve, pika 2 të bëhet: “Këshilli Kombëtar i Rinisë krijohet dhe kryesohet nga ministri përgjegjës për rininë dhe përbëhet nga 14 deri në 17 anëtarë”. Për sa kohë do t’ia japim këtë të drejtë ministrit, çdo ministër që do të vijë mund të ketë nevojë të zgjedhë konsulentët.

Sa i takon pikës 3, kriteret dhe procedurat duhet t’ia lëmë Këshillit të Ministrave dhe unë propozoj që kjo pikë të qëndrojë: “Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve, mënyra e organizimit dhe funksionimit të vet këshillit, të miratohen me vendim ministri”, pastaj ia propozojmë Këshillit të Ministrave...

(Diskutim pa mikrofon)

Bashkim, ky organ është i ri dhe nuk mund të ketë sukses nëse ne do ta lëmë vetëm në kuadrin e akteve nënligjore, dytësore të ministrit...

Ulsi Manja - Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Unë gjithmonë kam qenë në një linjë me zotin Hyseni, por këtë herë jam kundër. Pse jam kundër? Jam plotësisht dakord me shqetësimin e zonjës Hysi dhe zonjës Bushka.

Kur themi që Këshilli Kombëtar është këshillimor dhe drejtohet nga ministri për Rininë dhe do të ketë 14 deri në 17 anëtarë, atje mund të shtojmë një pikë ku të themi që shumica e tyre të përbëhet nga organizatat rinore. Kjo të vendoset në nen.

Pse jam për urdhrin e ministrit? Sepse është një organ këshillimor. Nuk mundet, o zotëri, se mua më duket absurde, t'i thuash qeverisë, ministrit të Mbrojtjes apo të Brendshëm – “Më mirato këta të rinjtë që do të jenë në këshillin tim”...

(Diskutim pa mikrofon)

Më lejo ta mbaroj, se po e bëj ironike.

Unë jam ministri i Rinisë dhe kam një numër prej 17 vetash këshilltarë dhe do t'u them ministrave të tjerë: “Më miratoni pak emrat e këtyre që do të më këshillojnë mua”. Pse? Ata janë këshillues, dhe në momentin që shtojmë edhe fjalinë e dytë, që gjysma e tyre do të jenë rinorë, absolutisht ia kemi mbyllur kllapat në ligj dhe i kemi thënë: “Gjysmat e anëtarëve do të jenë pjesë e organizatave rinore” dhe ti nuk ke të drejtë të vësh të njëjtat fytyra, siç tha zonja Hysi, por do t'i ndryshosh ato për të dhënë konsulta e këshillim më të mirë. Ndaj urdhrin duhet ta nxjerrë ministri dhe jo me vendim të Këshillit të Ministrave.

Edhe te neni 10 (më ndiq, Vasilika, se është edhe për ty, se je këshilltare) thuhet: “Këshilli Vendor i Rinisë”, do të bëjnë një këshill vendor për rininë këta, do të ketë edhe kryetari i Bashkisë së Tiranës një këshill vendor. Këshilli i Bashkisë do t'ia miratojë këshilltarët e vet kryetarit të bashkisë? Nuk ia miraton kurrë këshilli i bashkisë, pasi ai ka të tjera kompetenca. Këtu është vënë që duhet t'ia miratojë këshilli i bashkisë. Në mënyrë uniforme si kjo edhe neni 9 duhet të jetë me urdhër të ministrit. Më dëgjoni, sepse i them të gjitha nga eksperiencia këto.

Ulsi Manja -Faleminderit!

Zoti Hyseni, thoni edhe një propozim të fundit, sepse do të dëgjojmë edhe ministrinë e më pas duhet ta hedhim në votim.

Alket Hyseni – Rrallë ndodh që unë dhe zoti Fino të mos merremi vesh! Ose ndodh që ne nuk e kemi thënë saktë propozimin, ose ka diçka shumë parimore që duhet të ulemi, por në rastin konkret është e thjeshtë.

Ndajmë përbërjen nga rregullat e funksionimit. Unë propozoj që përbërja të jetë prerogativ e ministrit dhe me urdhër të tij. Kur themi te pika 2 “krijohet dhe kryesohet nga ministri”, e mbyllem këtë cikël. Është ai që e krijon.

Pika 3 flet vetëm për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve apo dhe për mënyrën e funksionimit. Pse bëhet kjo? Sepse ky këshill, nuk do të jetë vetëm thjesht këshillimor i ministrit, por është një këshill, i cili do të marrë një format tjetër që të ketë efekt ndryshe. Pra, pika 3 do të ketë vetëm rregullat e funksionimit.

(Diskutim pa mikrofon)

E shikon që ramë dakord!

Ulsi Manja -Ju lutem, se po zgjatemi!

Po, zoti Fino, përmbylleni mendimin, ju lutem!

Bashkim Fino – Jam plotësisht dakord që organizimi dhe funksionimi i Këshillit Kombëtar Rinor, si këshill, ta përcaktojë qeveria, nuk diskutohet, por unë fola për tjetër gjë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja -Zonja Haxhiu, fjala për ju.

Lorena Haxhiu – Faleminderit për sugjerimet dhe diskutimet produktive!

Për hir të së vërtetës, rinia është një fushë që i ka përgjegjësitë të shpërndara. Ndaj, para se të draftonim këtë projektligj, kemi nisur fillimisht me një kërkim të detajuar në mënyrë që të mos kishim mbivendosje me projektligjet që janë aktualisht në fuqi dhe që prekin targetgrupin e këtij projektligji, 15 deri në 29 vjeç.

Për këtë arsye, vizioni i Këshillit Kombëtar për Rininë nuk është vetëm vizioni që konsulton politikat e ministrisë përgjegjëse për rininë, por politikat për rininë në nivel kombëtar, që do të thotë se duhet të ketë një shpërndarje të barabartë midis përfaqësuesve të institucioneve publike qendrore dhe vendore dhe përfaqësuesve nga shoqëria civile. Si do të bëhet kjo ndarje? Ne kishim parashikuar një lloj ndarje që përfaqësuesit e institucioneve publike qendrore të ishin nga fushat kryesore të përgjegjësisë, pra përfaqësues të ministrive të linjës që përgjigjen për fusha të rëndësishme siç janë: punësimi, çështjet e shëndetit, mjedisi e të tjera, një pjesë në këtë këshill ta kenë edhe përfaqësuesit e këshillave vendorë të rinisë dhe pjesa tjetër të përzgjidhej nga organizatat rinore për të rinjtë me një numër të barabartë përfaqësuesish publik dhe shoqërisë civile.

Theksoj, zoti kryetar, që Këshilli Kombëtar i Rinisë nuk është i vetmi organ këshillimor, pasi, si njësi reference për konsultimin e politikave publike në terren për rininë do të shërbejë edhe Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore, e cila do të jetë në përbërje e organizatave rinore dhe atyre për të rinjtë.

Faleminderit!

Ulsi Manja –Faleminderit!

Që të jem i qartë pas gjithë diskutimeve të kolegëve, ta përmbledhim se si do ta votojmë nenin 9, që bëhet neni 10. Në pikën 2 pati një sugjerim që Këshilli Kombëtar i Rinisë të riformulohet në këtë mënyrë: “Të krijohet dhe kryesohet nga ministri përgjegjës për Rininë dhe të përbëhet nga 14 anëtarë”. Nga koleget Bushka dhe Hysi u kërkua të futet edhe sa për qind nga këta 14 anëtarë do të zënë organizatat rinore dhe shoqëria civile dhe të hiqet fjala “të cilët gëzojnë një mandat katërvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë”, sepse e ngritëm shumë lart stekën, e bëmë organ të krijuar me ligj, ose organ kushtetues, duke ia lidhur duart edhe ministrit se kush do të jetë këshilltari.

“Kriteret dhe procedurat e zgjedhjes së anëtarëve”, të mbetet e pandryshuar ndërsa “Mënyra e organizimit dhe funksionimit”, të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Jeni dakord që t’i përfshijmë në tekstin e nenit 9 dhe t’ia përcjellim komisionit përgjegjës këto sugjerime?

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 9, që bëhet neni 10.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Propozimi juaj ishte që ministri e krijon dhe e kryeson këtë këshill me 14 anëtarë, ndërsa mënyra e organizimit dhe funksionimit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Kalojmë te neni 10, që bëhet neni 11. Do t’u kërkoja kolegëve që i njëjti riformulim që u bë te neni 9, që u bë neni 10, të jetë edhe për Këshillin Vendor të Rinisë, sepse edhe këtu e keni lënë me vendim të Këshillit Bashkiak.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Bazuar në sugjerimet e zonjës Bushka dhe zotit Fino, do të doja edhe mendimin e ministrisë, por unë jam dakord të aplikojmë atë rregull edhe për Këshillin Vendor.

Ulsi Manja –Pra, i njëjti rregull që u përcaktua te neni 9, që u bë neni 10, lidhur me Këshillin Kombëtar të Rinisë, të bëhet edhe te Këshilli Vendor i Rinisë, neni 10, që u bë neni 11. Të reflektohen të njëjtat parime.

(Diskutim pa mikrofon)

15 anëtarë bëhen me gjithë ministrin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është dakord me nenin 10, që bëhet neni 11 “Këshilli Vendor i Rinisë”?

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Pyeta përfaqësuesit e ministrisë përse e kanë lënë me 4 anëtarë të bashkitë. Me të drejtë ata thonë që ka bashki që kaq mundësi kanë, por ka edhe të tjera që kanë organizata më shumë. Duhet të jemi fleksibël.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

4 anëtarë ti e quan dysHEME.

Duhet të thuash që “Këshilli Vendor i Rinisë është organ këshillimor, i cili përbëhet nga 4 deri në 7 anëtarë”. Bashkia e madhe e Tiranës mund të ketë 7, është barazim me ministrinë tënde, Bashkia e Këlcyrës dhe Bashkia e Dropullit mund të kenë 4 anëtarë, por bashkitë e qyteteve të mëdha si: Durrësi, Elbasani, Lushnja, Fieri e të tjera mund ta kenë me më shumë. Pra, për mua duhet të vendoset dysHEME dhe tavan.

Ulsi Manja –A ka mundësi ta lëmë vetëm me dysHEME jo më pak se 3, dhe pastaj kryetarët e bashkive ta çojnë sa të duan.

Lorena Haxhiu – Duhet të jetë të paktën 3, plus kryetarin bëhen 4, që do të thotë se kemi vendosur një dysHEME, ndërkohë tavanin e lëmë në varësi të zgjedhjes së vet bashkive.

Ulsi Manja – Jemi në të njëjtën gjatësi vale, duke e lënë jo më pak se 4, në varësi të nivelit të bashkive, sipas ligjit qeverisës vendor, më pas kryetarët e bashkive le të zgjedhin numrin e këshilltarëve që duhet të ketë Këshilli Vendor i Rinisë.

Alket Hyseni – Janë këshilla që do të kenë kosto, mos t’ua lëmë në dorë populizmave nëpër këshilla lokale dhe kryetarëve të bashkisë. Duhet të vëmë tavan siç vumë te neni më sipër. Do ta themi 4 deri në 7 anëtarë dhe e mbyllim këtë, duke ruajtur të njëjtën linjë. Të gjithë do të paguhen, të mos ua lëmë populizmave...

Ulsi Manja –Një sekondë, ju lutem! Pyesim edhe ministrinë.

Erzen Tola - Siç e kemi sqaruar edhe në relacion, të dy këshillat edhe në nivel kombëtar edhe në nivel vendor, janë këshilla konsultativë, të cilët do të jenë pa shpërblim.

Alket Hyseni –Ku e keni të shkruar?

Erzen Tola - Është shkruar në relacionin e projektligjit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Asnjë nga këta dy këshilla nuk do të paguhen.

Ulsi Manja – Asnjë njeri nuk të jep këshilla pa lekë, zoti Tola.

Erzen Tola - Pikërisht për këtë arsye nuk e kemi vendosur në ligj, sepse teknikisht nuk mund të vendoset, por këta janë këshilla konsultativë, të cilët do të jenë pa pagesë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vendimin do ta propozojmë ne.

Ulsi Manja – Askush nuk të këshillon pa lekë. Vetëm në Kuvendin e Shqipërisë punohet për 20 mbledhje komisioni në muaj pa shpërblim.

Atëherë, po e lëmë me përcaktim siç e bëmë për nenin 9, që u bë neni 10, edhe për Këshillin Vendor të Rinisë të bëhet me përcaktim numri jo më pak se 3, dhe jo më shumë se 7.

Kush është dakord?

Lorena Haxhiu – Zoti kryetar, vetëm një ndërhyrje, ju lutem!

Në qoftë se e vendosim 4 deri në 7, 7 plus kryetarin e bashkisë bëhen 8. Kështu që duhet të zgjidhet patjetër një numër...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erzen Tola - Në qoftë se mund ta sqaroj, në variantin e miratuar nga qeveria, tek të dy nenet përcaktohet që kryetari ose ministri kryesojnë këshillin dhe përbëhen nga jo më pak se kaq anëtarë. Pra, anëtarët dhe kryetari dalin gjithmonë me numër tek.

Ulsi Manja –A ka mundësi që kur të bëjmë raportin për komisionin përgjegjës, këtë çështjen e numrave se si do të dalë numri tek bashkë me kryetarin, është çështje tërësisht teknike, nëse do e lëmë 3 plus kryetarin, 4, por nëse e lëmë kryetari dhe 4 anëtarë, del numri tek. Në zbardhje, kur të bëjmë raportin...

Kush është dakord me nenin 10, që bëhet neni 11 me sugjerimet përkatëse? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 10.

Kalojmë te neni 11, që bëhet neni 12 “Organizatat Rinore”.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, është thjesht një riadresim “Shprehet në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse” dhe kemi thënë “të jenë organizata me veprimtari rinore”, germa “b” dhe germa “c” “70 % të anëtarëve të jenë të rinj”.

Janë saktësime.

Bashkim Fino – Te neni 5 biem ndesh, “Organizatat rinore mund të përfitojnë financime nga organet e pushtetit qendror nëpërmjet fondit grant të dedikuar për rininë, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe nga burime të tjera të ligjshme”. Ti këtu po ia thua me ligj dhe

organizata rinore i thotë bashkisë: “Më jep grantin që më takon nga njësitë e qeverisjes vendore”. Pra ti ia citon pushtetit vendor, i thua që duhet t’u japësh grantin organizatave rinore nga granti i vet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është dakord?

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Në aspektin e teknikës legislative, mendoj se në pikën 1 nuk është e nevojshme të shtojmë fjalët “...që krijohen në rregull”, por “...organizohen, transformohen dhe funksionojnë”. Unë mendoj se do të mjaftonte shprehja: “...që krijohen dhe funksionojnë në bazë të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë”.

Ulsi Manja – A jeni dakord?

Po, zoti Erzen.

Erzen Tola – Faleminderit, zonja deputete!

Unë dua të bëj një sqarim. Kjo kërkesë vjen nga organizatat aktuale, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre, të cilat kanë kërkuar me insistim që të parashikohet edhe mënyra e transformimit dhe organizimit për t’u kthyer edhe në rinore...

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, zoti Tola, sepse këtu jemi të gjithë juristë!

Në momentin që ti thua: “...në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë”, këtu është rregulluar mënyra e krijimit, organizimit dhe transformimit të një personi juridik.

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Hyseni, unë jam shumë dakord me sugjerimin që bëri edhe kolegja Xhina.

Atëherë, Kush është dakord me nenin 11, që bëhet neni 12? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 12, që bëhet neni 13 “Organizatat për të rinjtë”.

Vasilika Hysi – Kjo është thjesht për teknikë legislative, sepse ne kemi kërkuar që organizatat rinore të përmbushin kriteret dhe të jenë të regjistruara në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, duhet të kenë në mënyrë të vazhdueshme projekte, për të paktën një periudhë 3-vjeçare. Ne kemi saktësuar që jo çdo organizatë mund quhet organizatë rinore, nëse nuk ka

projekte me të rinjtë, të paktën për një periudhë 3-vjeçare. Njëkohësisht, nga teknika legislative ne sugjerojmë që pika 4 të kalojë në pikën 3 dhe pika 3 të kalojë në pikën 4.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni - Është me vend shqetësimi i organizatave, që jo thjesht të jenë të regjistruara në përputhje me legjislacionin në fuqi, por edhe të funksionojnë në përputhje me legjislacionin, sepse ka organizata që janë regjistruar para ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull! Pra, në vend të termit “të regjistruara”...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Unë nuk e kuptoj se ku qëndron shqetësimi këtu?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prisni se do ta them! Neni 13, pika 2, më duket shumë interesant, prandaj po pyes se çfarë shqetësimi ka. Këtu janë vendosur tri elemente: së pari, që duhet të jenë jo më pak se 30 organizata; së dyti, që duhet të jenë jo më pak se...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë lidhje ka kjo? Ju lutem, mos na ngatërmoni me nenet, por na i lexoni nenet ashtu siç janë! Më pas, kur të përfundojmë, le të quhet neni 13.

Ulsi Manja – Në rregull!

Kush është dakord me nenin 12 “Organizatat për të rinjtë”? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 13 “Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore”.

Vasilika Hysi – Ky është një ndër nenet më të diskutuara, ku nuk kemi gjetur ende një konsensus. Këtu jemi ndërmjet dy varianteve. Ne kemi pasur shumë diskutime, së pari, nëse në këtë nen duhet të detajojmë numrin e organizatave, që duhet të ketë Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore; së dyti, minimumin e numrit të anëtarëve, si dhe shtrirjen në territor. Modelet e ligjeve të rinisë në vendet e rajonit kanë të dhëna të detajuara, por përfaqësuesit e ministrisë thonë se te ne nuk ka një *database* të mirë dhe, duke vënë kritere kaq të ngurta, mund të çedojmë nëpërmjet nenit 2. Nga ana tjetër, nga konsultimet, që kemi bërë me ministren e Arsimit, zonzjen

Shahini, ajo kërkoi që kompetenca për të njohur Organizatën Kombëtare Përfaqësuese Rinore të mos jetë e ministrisë përgjegjëse (pra ajo pranoi sugjerimin tonë të bërë gjatë diskutimit në parim), por kërkoi që organizatat rinore të jenë të lira dhe të krijojnë organizata kombëtare, në qoftë se plotësojnë disa kritere, të cilat janë përcaktuar në Kodin Civil, si dhe në ligjin për organizmin dhe funksionimin e tyre. Për sa u përket kritereve që duhet të përmbushë organizata, këto do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Të nderuar kolegë, këtu ne kemi dy variante dhe diskutimi është i hapur, pasi nuk është gjetur ende një kompromis.

Bashkim Fino – Kjo gjë duhet zgjidhur, pasi nuk shkon që në një nen të vendosësh tri elemente. Mua më duket sikur vetëm emri nuk është ai i duhuri, sepse këtu thuhet: “Të drejtën për të themeluar Organizatën Kombëtare Përfaqësuese Rinore e kanë jo më pak se 30 organizata rinore”. Kjo mund të mbyllet këtu, por nuk mund të kemi besim, sepse mund të jenë 30 organizata, por nuk janë 1 mijë anëtarë ose mund të jenë 1 mijë anëtarë, por nuk zënë 70% të sipërfaqes së territorit. Pra, janë tri kritere, të cilat mua më vrasin syrin dhe më lind pyetja: çfarë shqetësimi ka në rastin konkret, kur vendosim 3 kritere brenda një neni? Mua kjo gjë më duket absurde.

Vasilika Hysi – Po varianti i dytë, si ju duket?

Bashkim Fino – Varianti i dytë është evaziv, është i hapur. Në variantin e dytë thuhet: “Të drejtën për të themeluar Organizatën Kombëtare Përfaqësuese Rinore e kanë organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë, të cilët pranojnë qëllimin, fushën e veprimtarisë e të tjera...”. Këtu ti i referohesh Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, por, duke iu referuar këtij Kodi (unë nuk e di në qoftë se këta janë dakord me Kodin Civil), kjo mbetet e hapur. Nisur nga mënyra se si ju i keni vendosur tri elementet këtu, më duket sikur ju e dini që ka një organizatë rinore, e cila e ka elementin e parë, por nuk e ka të dytin, ose e ka elementin e dytë, por nuk ka të tretin, ose ka dy elemente, por nuk ka një... Në momentin që ti i vendos të tria elementet në ligj këtë gjë, ti u thua këtyre organizatave: “Ti nuk i ke tri elementet, ndaj nuk quhesh, por, në qoftë se do t’i kishe të tria, atëherë do të quheshe”. Mua kjo më duket absurde, prandaj unë jam dakord me variantin e dytë që kjo gjë të zbatohet në bazë të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, duke i hequr të tria këto elemente.

Vasilika Hysi – Në fakt, unë do të doja që këshilltarja, Isida Koka, të lexonte variantin e dytë të ardhur sot në mëngjes nga ministria, i cili është më i dakordësuar.

Alket Hyseni – Unë do të mbështes variantin e dytë për shumë aspekte, sepse vlen logjika që tha zoti Fino, sepse ne bëjmë ligje duke parë edhe rrethanat, edhe kushtet. Kështu që le t'i lëmë kohë qeverisë të shikojë kritere ndoshta më strikte...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, jam dakord me variantin e dytë.

Ulsi Manja – Atëherë, ne e kalojmë nenin me variantin e dytë dhe ia përcjellim komisionit përgjegjës.

Kush është dakord me nenin 13, me variantin e dytë? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 14 “Puna rinore dhe punonjësi rinor”.

Vasilika Hysi – Te neni 14, zoti kryetar, ne do t'i sugjerojmë komisionit përgjegjës që titullin ta lerë “Puna rinore”, sepse nuk patëm komente dhe qartësime për punonjësin rinor. Njëkohësisht, në vijim të rekomandimit për germën “dh”, të nenit 2 “Përkufizimet”, komisioni përgjegjës duhet të vlerësojë nëse duhet ta lerë ose jo termin “Punonjës rinor” në pikat 3, 4 dhe 5 të këtij neni. Ne nuk jemi komisioni përgjegjës, kështu që nuk mund ta vendosim.

(Diskutime pa mikrofon)

Alket Hyseni – Mos harroni se ne kemi marrë edhe disa kusure pa meritë nga e kaluara. Këtë e kam për diskutim edhe me ministrinë. Pra, a mund zëvendësohet termi “puna rinore” me termat “aktivitet rinor” ose “veprimtari rinor”...

Ulsi Manja – Mos ndoshta termi “aktivitet” nënkupton vetëm punën...

Alket Hyseni – Atëherë, të vendosim termin “veprimtari rinore”, sepse mund të ketë konventa...

(Diskutime pa mikrofon)

Lorena Haxhiu - Dua të bëj vetëm një sqarim, sepse, sigurisht, do të ketë shumë diskutime, pasi kjo është një fushë e re dhe ky është një ligj, i cili draftohet për herë të parë në Republikën e Shqipërisë. Modelet e rajonit edhe të Europës na tregojnë se ata kanë ecur shumë më përpara në përputhje edhe me rekomandimet e BE-së, jo me direktivat, por me rekomandimet qoftë nga Komisioni European, qoftë edhe nga Këshilli i Europës, sepse puna rinore dhe punonjësi rinor në vendet e tjera europiane sot janë të njohura, madje kanë edhe ligje të veçanta që rregullohen. Kështu që definicioni që kemi para është një definicion “youth work”. Puna rinore është marrë si

definicion nga rekomandimet e Këshillit të Europës, që ka një fushë të veçantë vetëm për këtë çështje.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Atëherë, kush është dakord me nenin 14? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 15 “Burimet e financimit”.

Vasilika Hysi – Te neni 15 ka vetëm një formulim të pikës 3. Besoj se kolegu Fino ka komente.

Bashkim Fino – Unë dua të shprehem lidhur me nenin 15, që të shkruhet në procesverbal. Ky nen ka lidhje me nenin 7 dhe me diskutimin që bëra pak më parë, që do të thotë se burimet e financimit qenkan disa, pra që nga fondi grant i buxhetit të shtetit i dedikuar për rininë. Deri këtu jam dakord, sepse përderisa e krijojmë një ligj të tillë, qeveria duhet të japë fonde për rininë, por paska edhe buxhete vendore. Ti nuk ke të drejtë ta thuash këtu: “...të ardhura, donacione, sponsorizime dhe burime të tjera ligjore”. Unë jam plotësisht dakord me pjesën e parë, por në momentin që ti vendos buxhete vendore, atëherë ti e detyron pushtetin vendor të financojë edhe për rininë. Pra, është i njëjti diskutim që bëra për nenin 7, ndaj duhet të kemi parasysh:

Së pari, duke e vendosur këtu te burimet e financimit, ti u thua bashkive që unë të kam nxjerr ligjin “Për rininë” dhe me këtë ligj të detyroj të kesh buxhete vendore për rininë.

Së dyti...

Alket Hyseni – Po ky është synimi i ligjit.

Bashkim Fino – Ky është synimi i ligjit dhe unë jam dakord. Gjithashtu, si pushtet vendor jam dakord që ti të më japësh numrin e punonjësve, si dhe fondet që ta bëj këtë gjë. Unë të respektoj ty si ligjvënës, por, meqenëse jam drejtues i pushtetit vendor, ti duhet të më japësh mua numrin e punonjësve, si dhe fondin e pagave, apo buxhetet e tjera që unë të investoj për këtë fushë, sepse unë në bashki mund të kem 500 halle dhe mbase çështja e rinisë është e fundit që mendoj. Unë këtë kërkoja edhe te neni 7 dhe ju të gjithë më thatë se do ta shikojmë kur të vijmë te buxheti. Ndaj, tani që jemi te buxheti, unë jam i detyruar të flas për nenin 15, sepse këtu janë burimet e financimit dhe te burimet e financimit përfshihet edhe buxheti vendor.

Së dyti, dua t'u bëj një pyetje përfaqësuesve të ministrisë së linjës, sepse kam përshtypjen se pikat 2 dhe 3 bien ndesh nga pikëpamja financiare. Mbase ju me profesion nuk jeni financiarë, por unë jam.

Në pikën 2 thuhet: “Fondet e buxhetit të shtetit për rininë përcaktohen në buxhetin vjetor të shtetit për ministrinë përgjegjëse për rininë”. Pra, ne thamë se do të ketë X fonde për rininë.

Në pikën 3 thuhet: “Kriteret dhe procedurat për përdorimin e fondit grant të dedikuar për rininë nga buxheti i shtetit, për politikën, programet dhe projektet rinore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”. Pse do të përcaktohen këto fonde me vendim qeverie? Në qoftë se unë i jap një fond Ministrisë së Arsimit dhe këtë fond ia detajoj për arsimin parashkollor, për rininë e të tjera, nuk ka pse të ndërhyjë përsëri qeveria që të bëjë detajimin e tyre. Çfarë është kjo? Kjo është në kundërshtim me ligjin e buxhetit, përderisa qeveria e jep fondin, është ministrja ajo që e ndan më pas këtë fond, ashtu siç ndan për arsimin e të tjera. Pra, qeveria nuk duhet të nxjerrë një vendim tjetër për rininë dhe t'i thotë ministrisë: unë po të jap 1 milion euro dhe t'i këto para do t'i përdorësh për 2, 3, 4 apo 5 gjëra. Jo, në asnjë mënyrë, sepse kjo është pjesë e buxhetit të shtetit. Prandaj, bëjini në rregull ligjet, sepse nuk e dini se po ia lidhni këmbët vetes me këto shkresa që sillni këtu.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Po, zoti Tola.

Erzen Tola - Lidhur me përcaktimet në...

(Diskutime pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Ju lutem!

Po, mund të vazhdoni, zoti Tola.

Erzen Tola – Faleminderit!

Atëherë, lidhur me përcaktimet në pikën 2 dhe 3 të nenit 15, sqarojmë se kriteret dhe procedurat e parashikuara për t'u përcaktuar nga Këshilli i Ministrave lidhen me përdorimin e këtij fondi, i cili do të jetë mbi bazën e projekteve që do të aplikojnë organizatat rinore. Pra, Këshilli i Ministrave do të përcaktojë rregullat se si do të aplikojnë organizatat rinore për të përfituar fonde, si do të trajtohen këto projekte, si do të menaxhohen këto projekte që do të shpallen fituese. Pra, këtu vendimi i qeverisë nuk do të jetë i lidhur me detajimin e buxhetit të shtetit, por se si do të ndiqet kjo procedurë që sqarova më sipër.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Tola!

Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Unë, çuditërisht, do ta kundërshtoj fort zotin Fino. Synimi i ligjit është që, ndryshe nga herët e tjera, rinisë t’i jepet një rol i përcaktuar tashmë, jo me fjalë boshe, se është thënë vazhdimisht që do ta mbështesim rininë e të tjera. Këtu thuhet se në buxhet duhet parashikuar tashmë edhe fondi konkret për rininë. E thënë kjo në ligj, është një risi, sepse bëhet për herë të parë, ndaj duhet përshëndetur dhe mbështetur! Pra, duhet që fondet e pushtetit qendror, por edhe të pushtetit lokal, të jenë të përcaktuara në ligj dhe kjo nuk duhet të kundërshtohet. Kundërshtia, që pretendohet për pikën 3, përsëri ka vend për një rregullim nga ana e teknikës legislative, por, nga ana tjetër, Këshilli i Ministrave duhet të përcaktojë patjetër procedurat dhe kriteret se si do të përzgjidhen këto organizata edhe nga pushteti qendror, por edhe nga pushteti lokal.

Unë mendoj se duhet të hiqet vetëm termi “mënyra e përdorimit”, sepse mënyra e përdorimit është tagër i pushtetit lokal dhe nuk mund t’ia përcaktosh atij mënyrën. Së pari, e rëndësishme është që pushteti lokal të ketë fondin, pastaj kriteret dhe procedurat i ka me VKM, kurse mënyrat e përdorimit i zgjedh vetë Këshilli. Pra, te varianti i propozuar mendoj të hiqet termi “mënyra e përdorimit të këtij fondi” dhe pjesa tjetër të lihet siç është.

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Hyseni!

Unë kam një pyetje për pikën 2. Këtu thuhet: “Fondet e buxhetit të shtetit për rininë përcaktohen në buxhetin vjetor të shtetit për ministrinë përgjegjëse për rininë”. Si do të përcaktohet fondi i pushtetit vendor dedikuar rinisë?

(Diskutime pa mikrofon)

Erzen Tola – Atëherë, qëllimi ynë, nëpërmjet këtij parashikimi në ligj, është që buxhetet vendore do të parashikohen nga transfertat e pakushtëzuara, si pjesë e buxhetit që parashikohen për çdo bashki, ndërsa për ministrinë ky fond do të jetë i dedikuar në këtë formë për përdorim.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Atëherë, e hedhim në votim nenin 15 me sugjerimin e kolegut Hyseni.

Kush është pro? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 16 “Financimi i politikave, programeve dhe projekteve rinore”.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, këtu ka disa ndryshime të vogla.

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Kolegë, ju lutem, se kanë mbetur edhe pak nene dhe do ta mbyllim.

Vasilika Hysi – Këtu ka diçka për të rregulluar.

Së pari, fondi i dedikuar për rininë do të përdoret sipas nenit 15, pika 1, germa “a”.

Së dyti, rikonstrukcioni i tyre duhet të bëhet në përputhje me procedurat e parashikuara në legjislacionin në fuqi. Tashmë ka standarde se si duhet të jenë godinat, sepse këtë gjë e ka bërë ish-Ministria e Zhvillimit Urban. Këtu duhet të kemi parasysh standardet dhe rregullat.

Së treti, shtohen pikat 3 dhe pika 4, ku thuhet: “Planifikimi dhe zbatimi i procedurave të shpërndarjes së fondit grand të dedikuar për rininë, procedurat e përzgjedhjes, kontratat e të tjerë botohen në faqen zyrtare të institucionit”. Ne këtu kemi rritur transparencën. Pra, është shumë e domosdoshme të dimë se cilat janë organizatat përfituese që marrin fonde, si do t’i shpenzojnë e të tjerë, sepse janë para që vijnë nga taksapaguesit shqiptarë.

Së fundi, kemi shtuar edhe detyrimin për të shkëmbyer informacion me Agjencinë për Shoqërinë Civile, sepse edhe kësaj agjencie do t’i jepet fond, por edhe institucionit përgjegjës, që do të krijohet për rininë.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit, zonja Hysi!

Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni - Meqenëse për herë të parë po flasim për infrastrukturë, ne duhet të fusim dhe termin “akses”.

Vasilika Hysi – E kemi vënë te përkufizimet.

Alket Hyseni – Dakord, por këtu nuk e kemi!

Ne duhet të fusim termin e aksesit, sepse ndodh që bëhen godina të reja dhe pa akses për paraplegjikët, për kategori të caktuara.

Vasilika Hysi – E kemi thënë këtë gjë te përkufizimet.

Alket Hyseni – Në rregull, por duhet ta vendosim edhe këtu.

Kjo është çështje teknike.

Ulsi Manja - Kjo është çështje teknike, por le të përsëritet edhe këtu, sepse përsëritja është pjesë e teknikës legjislative dhe nuk i bën dëm projektit.

Atëherë, e hedhim në votim nenin 16 me sugjerimin e kolegut Hyseni për ta shtuar fjalën “akses” edhe këtu.

Kush është pro? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 17 “Infrastruktura rinore”.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Nuk ka propozime konkrete për këtë nen.

Ulsi Manja – Pra, për këtë nen nuk ka propozime konkrete, kështu që e hedhim në votim.

Kush është dakord me nenin 17? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 18 “Baza e të dhënave për rininë”.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Kjo është risi, sepse kemi futur dy elemente: rregullat e hollësishme të mënyrës së ngritjes, administrimit dhe përmbytjes së të dhënave caktohen me VKM, ndërsa ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale caktohen sipas ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 18, me sugjerimet e relatores? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 19 “Miratimi i akteve nënligjore”.

Vasilika Hysi - I rekomandojmë komisionit përgjegjës që të rishikojë afatet dhe, në përputhje me numërtimin e neneve, të përcaktojë edhe nxjerrjen e akteve ligjore brenda 9 muajve ose 6 muajve të hyrjes në fuqi të këtij ligji. Pra, këtë afat le ta përcaktojë vetë komisioni përgjegjës?

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 19, me sugjerimet e relatores? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni i fundit , neni 20 “Hyrja në fuqi”.

Kush është pro? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Para se ta kalojmë në votim në tërësi projektligjin, dua t’u them këshilltarëve që në momentin që do të zbardhin draftin dhe do të bëjnë raportin për komisionin përgjegjës, duhet të bëjnë edhe rinumërtimin e neneve për shkak të shtimit të një neni të ri në fillim. Pra, ky projektligj shkon te komisioni përgjegjës me 21 nene.

E hedhin në votimin në tërësi projektligjin.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.
Miratohet në tërësi projektligji “Për rininë”.

Ky projektligj, së bashku me raportin përkatës, si dhe me sugjerimet bëra nga kolegët e mi të komisionit, do t’i përcillet komisionit përgjegjës.

Me votimin në tërësi të këtij projektligji e mbylлим për sot mbledhjen e Komisionit të Ligjeve.

Faleminderit kolegëve për përfshirjen në debatin e këtij projektligji, i cili është risi, në fakt, për qeverinë shqiptare. Pra, ne bëhemi pjesë e shteteve që kemi një projektligj të dedikuar për rininë. Patjetër, do ta mbështesim me votën tonë edhe në seancën plenare.

Gjithashtu, dua të falënderoj kolegët, zëvendësministren e Arsimit, zonjën Haxhiu, si dhe zotin Tola për prezencën sot në Komisionin e Ligjeve!

Ditë të mbarë dhe javë të mbarë!

Më falni, ëmbëlsira për në fund, dua të falënderoj relatoren, zonjën Hysi, dhe këshilltarët e komisionit për punën dhe seriozitetin që kanë treguar për këtë projektligj! Ata kanë punuar javën e shkuar, e kanë dakordësuar dhe sot ne e kaluam në një kohë rekord.

Një falënderim të veçantë kam për kolegët e komisionit për lulet e bukura që më kanë dhuruar sot për ditëlindje dhe jo vetëm!

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA